



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 15.7.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Donika Kadaj-Bujupi dhe Milena Miliçević.

Munguan: Doruntinë Maloku, Nezir Çoçaj dhe Fatmir Limaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj – OSBE; Kaltrina Ahmeti – GLPS; Floriana Merovci- ZPRK; Etleva Ikonja, “Kosova Sot”; Blerta Bejtullahu-EUSR/EU Office; Muharrem Saragjollli – Radio Kosova; Hamit Mjeku dhe Zahir Çerkini- praktikantë në Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Armend Zemaj, propozoi që në rend dite të përfshihet edhe shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike. Ai arsyetoi se të gjitha amendamentet e propozuara janë shumë teknike dhe nuk ka ndonjë arsye të mos e shqyrtojmë sot.

Albulena Haxhiu, ishte kundër që të futet në rend dite shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës

Kryetarja, duke folur për raportin, tha se edhe buxheti në përgjithësi, edhe te ky rishikim i buxhetit, vërehet hapur që kjo Qeveri nuk ka ndonjë vizion, sepse e ka sjellë këtë rishikim vetëm sa për ta përmbushur obligimin procedural dhe nuk ka për qëllim zhvillimin ekonomik të vendit. Ajo e vlerësoi si shqetësues amendamentin 5 dhe 8, ku kemi 27 projekte, që është ndarë buxhet për Mitrovicën veriore. Në anën tjetër, asnjë amendament i deputetëve tjerë për ndërtim shkollash apo rrugësh, nuk është përkrahur. Këtë e quajti të padrejtë dhe standard të dyfishtë nga ana e Komisionit funksional. Për këto arsye, ajo tha se nuk e përkrah këtë raport. Po ashtu, ngriti shqetësimin e saj edhe lidhur me amendamentin e propozuar nga deputeti Faton Topalli, i cili ka kërkuar që të ndahen 25 milionë për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për punonjësit e Fabrikës së Gypave në Ferizaj.

Armend Zemaj, duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit, tha se ata që nuk kanë përvojë me çështjet buxhetore mund të bëjnë diskutime të tilla politike, sepse rishikimi i buxhetit i ka specifikat e veta dhe tanimë e kemi një buxhet të miratuar. Amendamenti 5, që iu referuat, ka të bëjë me nënprogramet dhe bashkëfinancimet që kanë qenë në komunat e pjesës veriore të Mitrovicës, me një kod të veçantë, i miratuar në buxhetin e vitit të kaluar. Shuma prej 3 milionë e 651 mijë euro, është shpërndarë dhe për këtë arsye nuk duhet të bëhen këso vlerësimesh, pa e analizuar strukturën e shpërndarjes së mjeteve. Më tutje, tha se ka qenë i mendimit që kjo në të ardhmen të mos ndodhë, pasi që ka shumë projekte që kërkojnë shuma të mëdha të investimeve, por nuk pranojnë që të ndahen në periudha kohore. Kjo logjikë vërehet edhe në amendamente tjera, ku një projekt që nuk ka përfunduar, mjetet shpërndahen në projekte tjera. Në fund, tha se duhet të kihet parasysh që në rishikim është e vështirë të futen projekte të reja.

Selviqe Halimi, në bazë të raportit të Komisionit funksional, shihet që nuk kemi ndonjë ndryshim substancial, por janë disa shpërndarje të vogla dhe asnjë ndryshim nuk është bërë pa u konsultuar me ministrinë përkatëse. Ky rishikim, kryesisht përfshin ato pjesë ku më tepër ka të bëjë me rishikim të projekteve. Ajo rikujtoi se, si Komision, në këtë fazë, shikohet vetëm përputhshmëria e projektligjit me Kushtetutën dhe nuk duhet të lëshohemi në çështje që nuk janë në fushëveprim të Komisionit. Duke u ndërlidhur me diskutimin e kryetares së Komisionit, tha se është e çuditshme pse nganjëherë aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese janë skajshmërisht të padrejta, ndërsa nganjëherë të drejta.

Albulena Haxhiu, duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolëses, tha se janë dy aktgjykime të Gjykatës Kushtetuese që unë i kam përkrahur, pra për Fabrikën e Gypave të Ferizajt dhe për heqjen e privilegjeve të deputetëve. Këto aktgjykime janë nxjerrë në vitin 2010, kurse degradimi i Gjykatës Kushtetuese ka filluar prej vitit 2012.

Agim Aliu, tha se çështjet e rishikimit të buxhetit, shpeshherë janë edhe çështje të pamjaftueshmërisë edhe të kohës, por edhe të mundësive për të bërë atë që është kërkesë e

deputetëve apo agjencive të ndryshme buxhetore, si proces i rishikimit. Më tutje, tha se ka kaluar kohë e gjatë dhe çështja e të bërit buxhet ka mbetur sfidë e institucioneve për faktin se kemi planifikime jo të mira. Diku kemi planifikime të vogla, vetëm sa për t'u futur në kod buxhetor dhe duhet të kemi parasysh faktin se sot kemi shumë projekte që zhvillohen me vite të tëra dhe nuk përfundojnë, pikërisht për shkak të pamjaftueshmërisë buxhetore. Po ashtu, kemi edhe projektet që janë copëzuar pastaj në projekte më të vogla dhe kjo është shqetësim i të gjithëve. Duke folur për çështjen e fabrikës së gypave, tha se i vjen keq që ata punëtorë nuk kanë mundur deri tani ta realizojnë të drejtën e tyre, kur dihet që kanë kaluar të gjitha instancat e rregullta gjyqësore. Amendamenti i propozuar nga deputeti Faton Topalli, më tepër është bërë për marketing politik, për faktin që të gjithë e dimë se ata tashmë kanë kaluar të gjitha instancat. Kurse çështja e pagesës së borxheve, ka shkaktuar komplikime buxhetore, që unë nuk kam qenë në legjislaturat e mëhershme.

Danush Ademi, duke iu referuar amendamentit 10, të propozuar nga Grupi Parlamentar 6+, tha se shpreh habinë pse nuk është përkrahur për faktin se ne nuk kemi kërkuar ndarje shtesë, por vetëm buxheti i alokuar për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, të ketë një kod edhe për komunitete tjera. Kjo, sepse Ministria për Komunitete dhe Kthim e ka keqpërdor buxhetin vetëm për një komunitet, pra për komunitetin serb.

Anëtarët e Komisionit: Albulena Haxhiu, Agim Aliu dhe Armend Zemaj, thanë se kjo është një kërkesë e drejtë e adresuar në amendamentin 10, që të ketë një ndarje të drejtë për të gjitha komunitetet, por që në këtë fazë, si Komision, nuk mund të bëjmë ndryshime në raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Pas debatit, kryetarja konstatoi se Komisioni, me 4 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara, mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara, mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu